

KONTRATA E KUOTAVE

Bazuar ne vendimin e Asamblese se Ortakeve te shoqërisë Lugano Home Collection Shpk, një shoqëri e krijuar dhe që vepron sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Shqipëri, më datë 08/01/2020, me numër unik të regjistrimit të biznesit M01310015F dhe me adrese: Rr. Monarkia shqiptare, Kamez, Tiranë, Shqipëri, me kapital në shumën 500.000 Leke, i ndarë në 1 kuotë.

Z.Osman Lala është dakord që 50% të kapitalit të zotëruara prej tij tek Lugano Home Collection shpk, t'ia ofrojë Ortakut te ri Z.Arben Lala, i cili shpreh dëshirën e tij për të marrë përqindjen e ofruar.

DUKE KONSIDERUAR SA MË SIPËR, Z.Osman Lala dhe Z.Arben Lala bien dakord që të lidhin këtë kontratë si vijon:

Neni 1 Objekti i Kontratës

1.1 Z.Osman Lala i dhuron Z.Arben Lala, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë, 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të zotëruar prej tij në kapitalin e shoqërisë Lugano Home Collection Shpk (më poshtë quajtur “**Kuota**”) dhe Z.Arben Lala do të disponojë këtë kuotë sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë në përgjithësi dhe dispozitave të parashikuara në Nenin 2 më poshtë.

Neni 2 Dispozitat e parashikuara

2.1 Palët bien dakord se kalimi i Kuotës, objekt i kësaj Kontrate përfaqëson vlerën nominale të Kuotës në shumën në total prej 250.000 Lekë, vlerë e cila pasqyrohet edhe në të dhënat e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit .

2.2 Palët pranojnë që nuk kane asnjë pretendim financiar ndaj njeri – tjetrit.

Neni 3 Kalimi i pronësisë dhe mbyllja e transaksionit

3.1 Kalimi i Kuotes, objekt i kësaj Kontrate, do të kalojë nga Z.Osman Lala tek Z.Arben Lala, dhe ky i fundit do të bëhet zotëruar me të drejta të plota i 1 kuote, që përfaqësojnë 50% të kapitalit të shoqërisë Lugano Home Collection Shpk në datën e depozitimit të kësaj Kontrate dhe regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 4 Tërësia e kontratës dhe ndryshimi i kushteve

4.1 Dispozitat e kësaj kontrate janë të ndara dhe nëse ndonjë prej tyre është ose bëhet e pavlefshme, e pasaktë apo e pazbatueshme në bazë të ligjit të aplikueshëm, pavlefshmëria,

pasaktësia apo pazbatueshmëria e kësaj dispozite nuk do të cënojë apo shfuqizojë dispozitat e tjera të kësaj kontrate. Çdo dispozitë e pavlefshme, e pasaktë apo e pazbatueshme do të zëvendësohet me një dispozitë tjetër të vlefshme, efektive dhe të zbatueshme që pasqyron efektet ligjore të së pares. I njëjti rregull aplikohet për gabimet apo përjashtimet e paqëllimshme.

4.2 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve lidhur me parashikimet në të. Titujt apo emërtimet e shprehura në këtë Kontratë janë përfshirë vetëm për lehtësi referimi në tekst dhe në këtë kontratë në tërësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kushteve dhe dispozitave të kësaj Kontrate.

4.3 Çdo parashikim i kësaj Kontrate mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga Palët e kësaj Kontrate.

Neni 5

Juridiksioni dhe mosmarrëveshjet

5.1 Kjo Kontratë bazohet dhe zbatohet sipas ligjit shqiptar, dhe interpretimi, vlefshmëria dhe përmbushja e saj realizohet dhe zbatohet në përputhje me ligjin shqiptar në fuqi. Çdo detyrim apo kusht lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate dhe që nuk parashikohet shprehimisht në këtë kontratë rregullohet nga Kodi Civil dhe dispozita të tjera ligjore.

5.2 Çdo mosmarrëveshje apo kundërshtim si rrjedhojë apo lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate që nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore ndërmjet Palëve, do të parashtrohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shqipëri.

Neni 6


Gjuha e kontratës

6.1 Kjo Kontratë hartohet në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë secila. Nga një ekzemplar i jepet secilës Palë, një ekzemplar depozitohet pranë Regjistrit Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

OSMAN LALA



ARBEN LALA



LHC
LUGANO HOME COLLECTION
Nipt: M01310015F